


Lajmet

*08/01/2024*

# Cërrik – Kapet Dhe Vihet Në Pranga 33-Vjeçari Që Kanosi Për Motive Të Dobëta, Një 40-Vjeçar, Dy Ditë Më Parë, Me Një Send Të Ngjashëm Me Armën E Zjarrit

Cërrik

Kapet dhe vihet në pranga 33-vjeçari që kanosi për motive të dobëta, një 40-vjeçar, dy ditë më parë, me një send të ngjashëm me armën e zjarrit.

Shërbimet e Policisë gjejnë në automjetin e 33-vjeçarit, sendin që dyshohet se ka përdorur ky shtetas, për kanosjen.

33-vjeçari i arrestuar, me precedent të mëparshëm kriminal në fushën e narkotikëve.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Cërrik, në zbatim të masave të përcaktuara në kuadër të operacionit policor kombëtar të koduar "Sundimi i ligjit", pas kallëzimit të një 40-vjeçari se ishte kanosur nga një shtetas, kanë organizuar punën për kapjen dhe nxjerrjen përpara përgjegjësisë ligjore të autorit dhe për zbardhjen e rrethanave të këtij rasti.

Si rezultat u bë kapja në lagjen nr 3, Cërrik, dhe arrestimi i shtetasit E. B., 33 vjeç, banues në Cërrik.

Ky shtetas u shpall në kërkim pasi nga veprimet hetimore të kryera pas kallëzimit të 40-vjeçarit, rezultoi se më datë 06.01.2024, në fshatin Shalës, e kishte kanosur këtë shtetas, për motive të dobëta, me një send të ngjashëm me armën e zjarrit.

Gjatë kontrollit në automjetin që drejtonte shtetasi E. B., shërbimet e Policisë kanë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale, sendin e ngjashëm me pistoletë, që dyshohet se është sendi i përdorur nga shtetasi E. B., për kanosjen.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për veprime të mëtejshme.

## angazhimpërkushtimsakrificë 👮 🚔

## tëvendosurkundërkrimit✅

## nëçdoskajtëvendit🇦🇱

## nëshërbimtëqytetarëve👮 🤝 🧑

## denonconë112📞 ✅

Gjirokastër/Mbante në dhomën e konviktit ku ishte akomoduar, lëndë narkotike cannabis sativa në trajtë çokollate, me qëllim shitjen në ambientet e konviktit dhe në ato të gjimnazit ku ishte nxënëse, arrestohet në flagrancë 17-vjeçarja

Tiranë/Vijon megaoperacioni policor i koduar "Tempulli"



Copyright © 2024 Policia e Shtetit. All rights reserved. Theme: ColorNews by ThemeGrill. Powered by WordPress.